



RAPORTI STATISTIKOR JANAR-KORRIK 2025

Hyrje

Ky raport ka për qëllim të ofrojë një përshkrim analitik të treguesve të primeve të shkruara bruto dhe të dëmeve të paguara në tregun e sigurimeve, me fokus të veçantë në shoqërinë Insig Jetë për periudhën Janar-Korrik 2025. Të dhënat do të paraqiten në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2024, si dhe me tregues specifikë për periudhën Janar-Korrik të viteve 2021 deri në 2025.

Burimet kryesore të informacionit për këtë raport janë Buletini Statistikor i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Korrik 2025, si dhe të dhëna të tjera nga burimet e shoqërisë Insig Jetë.

Tabela e përmbajtjes

1. Tregu i sigurimeve për periudhën Janar-Korrik 2025.....	4
1.1 Primet e shkruara bruto nga aktiviteti i Jetës	4
1.2 Dëmet e paguara nga aktiviteti i Jetës	7
2. Primet e shkruara bruto për shoqërinë Insig Jetë, Janar-Korrik 2025.....	9
2.1 Primet e shkruara bruto për klasën e sigurimit të Jetës së Debitorit.....	9
2.2 Primet e shkruara bruto për klasat e tjera	10
3. Dëmet e paguara nga shoqëria Insig Jetë, Janar-Korrik 2025	11

1. Tregu i sigurimeve për periudhën Janar-Korrik 2025

Gjatë periudhës Janar-Korrik 2025, tregu i sigurimeve ka realizuar 15,473,413 mijë lekë në prime të shkruara bruto, duke shënuar një rritje prej 8.98% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024.

Primet e Realizuara:

1. Sektori i Jo Jetës: 91.34%
2. Sektori i Jetës: 8.63%
3. Veprimtaria e Risigurimeve: 0.030%

Vlera e dëmeve të paguara nga industria e sigurimeve arrin në 4,804,396 mijë lekë, ose 0.90% më shumë se në periudhën Janar-Korrik 2024.

Dëmet e Pagura:

1. Aktiviteti i Jo Jetës: 90.98%
2. Aktiviteti i Jetës: 4.37%
3. Fondi i Kompensimit: 4.65%


1.1 Primet e shkruara bruto nga aktiviteti i Jetës

Totali i primeve të shkruara bruto nga aktiviteti i Jetës është 1,335,110 mijë lekë, duke shënuar një rritje prej 13.18% krahasuar me periudhën Janar-Korrik 2024, një tregues pozitiv për këtë sektor. Klasa e sigurimit "Jeta e debitorit" ka kontribuar më së shumti në këtë rritje.

Megjithatë, llojet e tjera të sigurimit, si Jetë dhe Shëndet në Udhëtim dhe Sigurimi Jeta e Nxënësit kanë shënuar rënie krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Të dhënat janë të paraqitura si në grafikun 1.

Grafiku 1: Ndryshimi i primeve të shkruara bruto sipas klasave të sigurimit, Janar-Korrik 2025/2024




Burimi: AMF, përpunoi autori

Analiza e Primeve të Realizuara

- Viti 2021: Vlera më e ulët e primeve në pesë vjeçarin e fundit.
- Periudha Janar-Korrik 2025: Rritje prej rreth 13.18% krahasuar me vitin 2024.
- Krahasimi me 2023: Rritje prej afro 28.07%.


Grafiku 2: Ecuria e primeve të shkruara bruto, Janar-Korrik 2021-2025 (mijë lekë)



Burimi: AMF, përpunoi autori

Tregu i sigurimeve të jetës karakterizohet nga dominimi i sigurimeve Jetë Debitori, të cilat përbëjnë rreth 81.10% të totalit të primeve të grumbulluara. Pjesa tjetër është e shpërndarë sipas grafikut 3, që ilustron ndarjen e llojeve të sigurimeve të jetës.

Grafiku 3: Përpjesa e primeve bruto sipas të llojit të sigurimeve ndaj totalit, Janar-Korrik 2025




Burimi: AMF, përpunoi autori

Gjatë periudhës Janar-Korrik 2025, numri i kontratave të lidhura për sigurimet e jetës arriti në 97,928 duke shënuar një rritje prej 13.20% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Në aspektin e primeve të shkruara bruto, tregu i sigurimeve të jetës dominohet nga shoqëria Albsig Jeta, e cila zotëron rreth 36.20% të tregut. Ajo ndiqet nga Sigal Life me rreth 32.09%, Insig Jetë me 17.02%, Sicred me 14.34% dhe Viena Life Insurance me 0.34%.

Grafiku 4: Ndarja e tregut të sigurimeve të Jetës, Janar-Korrik 2025




Burimi: AMF, përpunoi autori

Norma e rritjes së tregut të sigurimeve të jetës është 13.18 % në krahasim me Janar-Korrik 2024. Shoqëria që ka regjistruar rritjen më të madhe është Albsig Jetë, me një normë rritje prej 84.32% e njekur nga Sicred me nje rritje prej 11.67%.

Sigal Life ka përjetuar një rënie prej 10.03% gjithashtu dhe Insig Jeta ka përjetuar një rënie prej 15.74% .

Grafiku 5: Norma e rritjes së primit, Janar-Korrik 2025/2024




Burimi: AMF, përpunoi autori

1.2 Dëmet e paguara nga aktiviteti i Jetës

Gjatë muajit Janar-Korrik 2025, nga aktiviteti i sigurimit të jetës janë paguar 209,970 mijë lekë dëme, duke shënuar një rritje prej rreth 14.01% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024. Kjo tregon një tendencë në rritje të dëmeve të paguara në sektorin e sigurimeve të Jetës.


Grafiku 7: Ecuria e dëmeve të paguara nga tregu (mijë lekë), Janar-Korrik 2021-2025



Burimi: AMF, përpunoi autori

Sipas grafikut 7, vlera më e lartë e dëmeve të paguara gjatë muajit Janar-Korrik 2021 është e evidentuar për të gjithë pesëvjeçarin. Kjo rritje e dukshme është kryesisht rezultat i rritjes në vlerë të dëmeve të paguara bruto nga kompania Sigal Life Uniqa Group Austria.


Grafiku 8: Ndryshimi në dëmet e paguara sipas klasave të sigurimeve, Janar-Korrik 2025/2024



Burimi: AMF, përpunoi autori

Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara nga shoqëritë e sigurimit që operojnë në tregun e jetës shpërndahen sipas ilustrimit grafik 9.

Grafiku 9: Ndarja e tregut të sigurimeve të Jetës për dëmet e paguara, Janar-Korrik 2025




Burimi: AMF, përpunoi autori

2. Primet e shkruara bruto për shoqërinë Insig Jetë, Janar-Korrik 2025

Gjatë muajit Janar-Korrik 2025, shoqëria Insig Jetë realizoi 227,284 mijë lekë prime të shkruara bruto, duke shënuar një rënie prej 15.74% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024.

Ecuria e primeve të shoqërisë Insig Jetë nga viti 2021 deri në vitin 2025 tregon lëvizje të ndryshme, me rritjen më të madhe regjistruar nga viti 2022 në vitin 2023.

Grafiku 10: Ecuria e primeve të shkruara bruto për Insig Jetë, Janar-Korrik 2021-2025 (mijë lekë)



Burimi: AMF, përpunoi autori


2.1 Primet e shkruara bruto për klasën e sigurimit të Jetës së Debitorit

Gjatë periudhës Janar-Korrik 2025, nga klasa e sigurimit të jetës së debitorit janë grumbulluar 1,082,715 mijë lekë prime të shkruara bruto, që përbën një rritje prej rreth 17.03% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024. **Sigurimi i Jetës së Debitorit zë rreth 81.10% të totalit të primeve të shkruara bruto në treg.**

Në treg, shoqëria Insig Jetë mban 13.19% të totalit për këtë klasë sigurimi duke shënuar një rënie prej 26.42%.

Grafiku 11 ilustron ecurinë e primeve të shkruara për sigurimin e Jetës së Debitorit për Insig Jetë gjatë periudhës Janar-Korrik 2021-2025. Vlera më e ulët e primeve të grumbulluara është regjistruar në vitin 2021, ndërsa vlera më e lartë është arritur në vitin 2024.

Grafiku 11: Primet e shkruara bruto Insig Jetë për klasën Jetë Debitori, Janar-Korrik 2021-2025 (mijë lekë)




Burimi: Të dhëna Insig Jetë, përpunoi autori

2.2 Primet e shkruara bruto për klasat e tjera

Pjesa tjetër e primeve të realizuara nga shoqëria Insig Jetë përbëhet nga klasat e sigurimeve të jetës, si Jeta e Nxënësit dhe Studentit, Jeta në Grup, Jeta dhe Shëndeti Flexi Plan, Jeta dhe Shëndeti në Udhëtim, dhe së fundi, Jeta dhe Shëndeti i Studentit.

Të përmbledhura grafikisht paraqiten të dhënat për klasat e tjera të sigurimit sipas grafikut 12.

Grafiku 12: Ecuria e primeve të Insig Jetë për klasat e tjera, Janar-Korrik 2021-2025 (mijë lekë)



Burimi: Të dhëna Insig Jetë, përpunoi autori

Produkti Flexi përbën 23.7% të primeve të shkruara, ndërsa sigurimi Jetë në Grup me Aksidente Personale përfaqëson 13.1%. Llojet e tjera të sigurimeve kontribuojnë me 0.3%.

Në përmbledhje, të gjitha llojet e sigurimeve që shoqëria Insig Jetë ofron për tregun e Sigurimeve të Jetës janë paraqitur në tabelën 1, e cila ilustron ndryshimet e regjistruara krahasuar me vitin 2024.

Tabela 1: Primet e shkruara bruto Insig Jetë Janar-Korrik 2025/2024 (mijë lekë)

Primet Bruto 2021-2025

Lloji I sigurimt	01_07_2024	01_07_2025	Ndryshimi ne % ndaj totalit	Ndryshimi ne % 25/24
1-sigurimi i jetes debitorit	194,039	142,782	62.8%	-26%
2-sigurimi i jetes nxenes dhe studenti	35	-	0.0%	0%
3-sigurim jete ne grup me AP	24,930	29,817	13.1%	20%
4-sigurimi i jetes dhe shendet studenti	109	66	0.0%	100%
5-sigurim jete dhe shendet ne udhetim	1,042	667	0.3%	-36%
6-sigurimi i flex plan	49,579	53,949	23.7%	9%
Totali	269,737	227,284	100.00%	-16%


Burimi: Të dhëna Insig Jetë

3. Dëmet e paguara nga shoqëria Insig Jetë, Janar-Korrik 2025

Gjatë muajit Janar-Korrik 2025, totali i dëmeve të paguara nga shoqëria Insig Jetë arriti në 53,490 mijë lekë, duke shënuar një rritje prej 43.32% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2024. Raporti i dëmeve ndaj primeve për Janar-Korrik 2025 është 15.72%. Në raport me totalin e dëmeve të paguara në treg, shoqëria Insig Jetë përfaqëson 25.48% të tyre. Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara vjen nga mbulimet e ofruara, siç janë:

- Sigurimi i Jetës dhe Shëndetit Flexi plan: 28.8%
- Klasa e sigurimeve Jetë Debitori: 52.47%
- Jetë në Grup me Aksidente Personale: 18.41%

Grafiku 13: Pjesa e dëmeve të paguara nga llojet e sigurimit Insig Jetë, Janar-Korrik 2025



Burimi: Të dhëna Insig Jetë, përpunoi autori